



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 661/5 Prot.

Tiranë, më 29.04.2021

VENDIM

Nr. 79, datë 29.04.2021

PËR

SHTYRJEN E AFATIT TË APLIKIMIT PËR KANDIDATËT E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME NË UST

Në zbatim të neneve 38 (pika 1, gërma “i”), 46 (pika 3) të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, të neneve 20 (gërma “n”), 26 të Statutit e UST-së në nenin 10 të Rregullore së UST-së, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 29/04/2021 si dhe në Vendimin e Senatit Akademik nr. 70 datë 23/04/2021 “Për hapjen e procesit për aplikim të kandidatëve të Komisionit të sigurimit të standarteve të cilësisë, botimeve dhe projekteve shkencore, Komisionit të Kurrikulave si dhe Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtariisë dhe të marrëdhënieve me studentët, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 23/04/2021,

VENDOSI

1. Shtyrjen e afatit të regjistrimit të kandidateve deri me **05/05/2021** të Komisioneve të Përshme të mëposhtme :
 - *Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore;*
 - *Komisionit të Kurrikulave;*
 - *Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtariisë dhe të Marrëdhënieve me Studentët.*
2. Ngarkohet Sekretari i Senatit Akademik për zbatimin e këtij vendimi.
3. Shtyrja e afatit të aplikimit të kandidatëve në Komisionet e Përshme të pasqyrohet dhe në njoftimin e vendosur në faqen zyrtare të internetit të UST-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK



PROF. DR. AGRON KASA